

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                           |
|---------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Gjykata e Lartë la në burg Veliajn, Ndreca: Po mbahet peng ushtrimi i mandatit të kryetarit të bashkisë                                                                                                                                   |
| ADRESA  | <a href="https://a2news.com/shqiperia/kronike/gjykata-e-larte-la-ne-burg-veliajn-ndreca-po-mbahet-peng-ushter-i1185090">https://a2news.com/shqiperia/kronike/gjykata-e-larte-la-ne-burg-veliajn-ndreca-po-mbahet-peng-ushter-i1185090</a> |
| BURIMI  | a2news.com                                                                                                                                                                                                                                |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                                                                                    |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 15 shtator 2026, 11:21:25 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 15 shtator 2026, 11:12:00 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 4d5e4a4b003a2a723e4d8f82f6543a38f3d5fcc29443c23eb5ec57778bfe3fbc |
| TEKSTI     | f6b4c7afd9f2ef2716b4143b03fe73557f116058f57dcfe85755933e7cbe5a05 |
| PAMJA      | 1c8ec0ff6094ee47ddd06dfd5af2c99af9ff75c2fd0e51284507ffce67dbe1f4 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | 7e8100dfe95ee99c02f7b0172664cde2c94eb1b9b58e0953bf4d8920ede12966                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | 93a0feb7bb19154a540f480bce1eeee0b2224e0180d4198842f090d06654d15a                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7e8100dfe95ee99c02f7b0172664cde2c94eb1b9b58e0953bf4d8920ede12966>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



# Gjykata e Lartë la në burg Veliajn, Ndreca: Po mbahet peng ushtrimi i mandatit të kryetarit të bashkisë

Nga A2 CNN  
15 Shtator 2026, 13:12 | Kronikë



Avokati i Erion Veliajt, Plarent Ndreca, në një reagim në rrjetet sociale pas vendimit të Gjykatës së Lartë, që e la në burg kryebashkiakun, e konsideroi atë një zhvillim jashtëzakonisht shqetësues për shtetin e së drejtës, sigurinë juridike, të drejtat themelore dhe mbi të gjitha, për demokracinë në këtë vend.

*"Duke lënë në fuqi një vendimmarrje të shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese, ky vendim praktikisht ka lënë pa efekt detyrues vendimin e autoritetit më të lartë kushtetues të vendit. Sigurisht, do ta analizojmë me përgjegjësi arsyetimin e plotë. Por rezultati i shpallur sot ngre një pyetje dramatike: çfarë vlere kanë garancitë kushtetuese nëse vendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk zbatohen efektivisht? Kur një përfundim i tillë nuk gjen shpjegim bindës në Kushtetutë dhe në ligj, atëherë shkaqet duhen kërkuar përtej argumenteve juridike dhe jashtë sallës së gjyqit", shkruan Ndreca.*

Sipas mbrojtjes ligjore, pasojat e këtij vendimi tejkalojnë procesin individual të Veliajt, meqenëse mbajnë peng funksionimin e zakonshëm të Bashkisë së Tiranës dhe shkelin vullnetin e qytetarëve. Ndreca nënvizoi se prej 19 muajsh kryeqyteti privohet nga drejtuesi i zgjedhur me votë, ndërkohë që Veliaj vazhdon të mbahet në paraburgim edhe pse hetimet kanë përfunduar prej një viti.

*"Pasojat shkojnë përtej një procesi individual. Ato mbajnë peng ushtrimin e mandatit të kryetarit të zgjedhur të Bashkisë së Tiranës, funksionimin normal të institucionit dhe vullnetin e qytetarëve të shprehur me votë. Prej 19 muajsh, qytetarët e Tiranës janë privuar nga kryetari që kanë zgjedhur. Z. Erion Veliaj prezumohet i pafajshëm dhe vazhdon të mbahet në paraburgim, ndonëse hetimi ka përfunduar prej një viti dhe çështja ndodhet në gjykim. E gjithë kjo nuk është arsye për t'u dorëzuar, por për ta vijuar betejën. Mund ta izolojnë dhe t'i kufizojnë mundësinë për të folur, por nuk mund ta mundin politikisht nëpërmjet vendimeve gjyqësore. Një politikan mundet me votë, përballë qytetarëve, dhe jo përmes "lawfare"-it. Ne do të përdorim çdo mjet juridik që parashikon Kushtetuta, ligji dhe instrumentet ndërkombëtare. Shqipëria meriton një drejtësi të standardeve evropiane, e cila garanton të drejtat, respekton vendimet kushtetuese dhe mbron demokracinë, mjetin më të lartë që qytetarët kanë në dorë për të vendosur se kush i përfaqëson dhe kush e drejton vendin".*

(A2 Televizion)

A2 CNN **Livestream**

## TE FUNDIT

Prag Liga e Kombeve, Seferi dhe Asani nuk ndalen, protagonistët me ekipet e tyre

"E vetmja që fiton është Kina", Trump: Një konspiracion i sëmurë kundër IA

Dy yjet më të shtrenjtë, Yamal dhe Haaland marrin skenën e futbollit botëror

Depistimi i fëmijëve në shkollë, ministrja Spahiu: Protokolle të qarta edhe për trajtimin në vijueshmëri

## MË TË VIZITUARAT

Paguan 5 milionë lekë të vjetra, Tërana rikthen tifozët bardheblu për duelin ...

Hap i madh në karrierë, Përndreca gati për t'u transferuar në Emiratet e Bas...

Dueli me Teutën, Vllaznia në një krizë, as gola dhe as rezultate

## LIVE UPDATES

Mbretëria e Bashkuar paralajmëron paketë të re sanksionesh ndaj Rusisë

LIVE | Gjithçka rreth Samitit Ukrainë-Europa Juglindore

Blinken në Tiranë, vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Shqipëri

#### MUND TE LEXONI GJITHASHTU



Ilir Meta mbetet në burg, rrëzohet kërkesa për lirin nga qelia



Arrestohet në Belgjikë 58-vjeçari nga Shijaku, anëtar i një organizate kriminale



Operacioni i AMP-së, arrestohet efektiv i Policisë në Durrës, procedohen dy të tjerë



Gjykata e Lartë lë në burg Erion Veliajn



Shpërthim me lëndë plasëse në oborrin e një banese në Shijak



Sekuestrohen 3 automjete luksoze në Vlorë, nis hetimi pasuror ndaj pronarëve të tyre

## Latest Videos



Paguhen nga 10 mijë euro në muaj, avokati akuzon prokurorët e SPAK: Nuk japin dot prova në gjyq



Veliaj mbetet në burg, Cakrani analizon vendimin e Gjykatës: Mund të helmojë provat



Gjykata ndryshoi praktikën e KAS për Veliajn? Avokati hedh poshtë pretendimet: SPAK e provoi që...



Meta mbetet në burg, çfarë mendon Kujtim Cakrani?

#### Shqipëria

Aktualitet  
Kronikë  
Politikë  
Ekonomi  
Sociale  
Kulturë  
Moti

#### Kosova

Kulturë  
Sociale  
Ekonomi  
Politikë  
Kronikë  
Aktualitet

#### Rajoni & Bota

Balkani  
Bota

#### Argëtim

Showbiz  
Lifestyle  
Kapur në kamera  
Teknologji

#### Sport

Live Euro 2024  
Futboll  
Sporte të tjera

#### Speciale A2

5 gjëra në 5 minuta  
A2 CNN në Izrael  
31 Minuta  
A2 CNN në Ukrainë  
Lumi i kokainës  
Ditari ndërkombëtar  
Zbulio  
Imagjinatë  
Dëshmi



A2 CNN LOGO

Live TV

Rreth nesh Kushtet e Privatësisë Karriera Kontakt

© 2023 A2 CNN / G2 Media shpk  
All Rights Reserved.

Mundësiuar nga Mediadesk

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.